



Pranuar / Dorezuar Punëpunësi/Proutato Received/Delivered	28.04.2023	3 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTCK	3954/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.541/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.541/2023 të datës 20.03.2023 të parashtruar nga ankuesi nga Mitrovica e Jugut, kundër organit të punësimit Komunes së Mitrovicës Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e palejuar ankesa me numër A.nr.541/2023 e datës 20.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje ankuesi) i punësuar në Komunën e Mitrovicës se Jugut, më datë 20.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 10.03.2023 të Udhëheqësit së Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), për periudhën nga muaji mars 2020 deri në muajin dhjetor 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës se Jugut. Ndërsa, Këshillime datë 13.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2803/2023 të datës 20.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të referencës 01 120/08-080014250/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi tek Burimet Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Ndryshim dhe Plotësimin e Aktit të emërimit me numër të protokollit 01-112/02-0028822-3/2020 të datës 23.06.2020; Vendimin me numër A.nr.840/2022 të datës 14.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.03.2023; Përgjigjen në anekse të datës 13.04.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike të datës 24.09.2012; Përgjigjenin në kërkesë me numër reference; 01-120/08-001 14250-2/2023 të datës 10.03.2023; Akt emërimin e datës 23.06.2020;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit me numër 01-112/02-0028822-3/2020 të datës 23.06.2020 është emëruar Zyrtar i Lartë Ligjor. I njëjti më datë 30.09.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.840/2022 të datës 14.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës, më datë 30.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin AE.Nr.01-112/01-0106419/22 me koeficient tetë (8) të pagës.

Ankuesi më datë 21.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Lipjanit për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive gjegjësisht për periudhën nga muaji mars 2020 deri në muajin dhjetor 2022. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 10.03.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 21.02.2023 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 10.03.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Mitrovicës, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), për periudhën nga muaji mars 2020 deri në muajin dhjetor 2022.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficienteve, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 23.06.2020 ka nënshkruar pa vërejtje Aktin e emërimit për pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 30.09.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm

Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 23.06.2020), përkatësisht nenin 127 të këtij ligji ku përcaktohej se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.541 /2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

